



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.
2018

Ballsh, më ____ . ____ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 10.09.2018

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë "BOSHNJAKU.B" shpk, me NIPT K72627402H & "PESE VELLEZERIT" shpk, me NIPT L22925402C, me adresë Lagja "Bishanake", Rruga "Skënderbeu", Nr. 8, Pranë karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr.8532, Fier.**

* * *

Procedura e prokurimit: **"E hapur"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-80836-07-26-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh"**, me fond limit **62.952.642** (gjashtëdhjetë e dymilion e nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e dyzetë e dy) **lekë pa TVSH**, me afat 5 muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.30, datë 30 korrik 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "BOSHNJAKU. B" shpk, me NIPT K72627402H & "PESE VELLEZERIT" shpk, me NIPT L22925402C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 60.416.378 (gjashtëdhjetëmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.



2. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk, me NIPT K67106202W, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. Operatori Ekonomik “FLED” shpk, me NIPT K17621104C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 62.115.626 (gjashtëdhjetë e dymilion e njëqind e pesëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, me NIPT L38109801T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 61.065.210 (gjashtëdhjetë e njëmilion e gjashtëdhjetë e pesëmijë e dyqind e dhjetë) lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

2. Operatori Ekonomik “FLED” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.2. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur kopjet e çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017).
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.2. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vendore për vitet 2016, 2017, lëshuar prej njësisë së vetqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, referuar adresave kryesore dhe dytësore ku është regjistruar sipas QKB.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, pasi kontrata e paraqitur, me objekt “Rikualifikim i qendrës dhe fasadës së shkollës Capan”, lidhur me Bashkinë Skrapar është me vlerë më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet pa TVSH .
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me kategoritë e kërkuara të liçencës, pasi nuk zotëron kategorinë NP-3C dhe NS-9A.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me çertifikatat e cilësisë, pasi nuk ka çertifikatat e cilësisë si ISO 50001:2011, ISO 3834-2:2016 etj.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, pasi nuk ka



paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon ose zotëron në një nga format e kërkuara (pronësi/ qera/ kontratë noteriale furnizimi): 2 Kamiona (nga 3 të kërkuar ka vetëm 1), 1 Kamionçinë (nga 2 të kërkuara ka vetëm 1), 1 Tërheqës, 1 Rimorkiator për transportin e mjeteve të rënda, 1 Grejder, 2 Eskavator me gomë, 1 Autovinç/kamion me vinç, 2 Autobetoniere, 1 Autopompë betoni, 2 Vinça kollonë kantieri, 3 Gjeneratorë, 3 Betoniere, 3 Motosaldatriçe, 1500 m² Armaturë (dërrasë ose panele), 1500 m² Skeleri, 1500 m² Rrjetë suvatimi, 1 Aparat saldimi tubo çeliku, 1 Aparat saldimi tubo plastike, 1 Fabrikë betoni etj.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka numrin e punonjësve të kërkuar për periudhën qershor 2015-gusht 2018.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “f”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka pjesë të stafit të tij 1 arkitekt, 1 mjek, 1 teknik ndërtimi, 3 karpentierë, 2 manovratorë etj.

3. Operatori Ekonomik “GRAND KONSTRUKSION M” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.2. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore të xhiros vjetore të tre viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017).
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, pasi kontratat e paraqitura, nuk konsiderohen si punime të ngjashme pasi nuk kanë ngjashmëri me punimet objekt kontrate. Konkretisht kontrata me objekt “Masa inxhinierike për mirëmbajtjen e linjës së ujësjellësit, fshati Bence, Tepelenë”, lidhur me ShA Ujësjellës Tepelenë nuk është kontratë e të njëjtës natyrë dhe nuk ka ngjashmëri me kontratën objekt prokurimi dhe për rrjedhim nuk merret në konsideratë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme. Kontrata me objekt “Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”, lidhur me ish Bashkinë Ballsh, nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nuk është kontratë e të njëjtës natyrë dhe nuk ka ngjashmëri me kontratën objekt prokurimi dhe për rrjedhim nuk merret në konsideratë për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me kategoritë e kërkuara të liçencës, pasi nuk zotëron kategorinë NP-3C, NP-12A, NS-8A, NS-9A, NS-12A, NS-14A dhe NS-18A.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me çertifikatat e cilësisë, pasi nuk ka çertifikatat e cilësisë si ISO 50001:2011, ISO 3834-2:2016, ISO SA 8000:2014 etj.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon ose zotëron në një nga format e kërkuara (pronësi/ qera/ kontratë noteriale furnizimi): 1 Autovinç/ kamion me vinç, 2 Autobetoniere, 1 Autopompë betoni, 2 Vinça kollonë kantieri, 1500 m² Armaturë (dërrasë ose panele), 1500



m² Skeleri, 1500 m² Rrjetë suvatimi, 1 Aparat saldimi tubo çeliku, 1 Aparat saldimi tubo plastike, 1 Fabrikë betoni etj.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka numrin e punonjësve të kërkuar për periudhën qershor 2015-gusht 2018.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “f”, të pikës 2.3 “Për kapacitetin teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 12 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka pjesë të stafit të tij drejtuesit teknik të kërkuar si: 2 inxhinierë ndërtimi, 1 inxhinier mekanik, 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier topograf/gjeodet/markshjdhër, 1 inxhinier mjedisi etj. Nuk ka paraqitur gjithashtu, dokumentacion që vërteton se ka pjesë të stafit të tij 1 mjek, 1 teknik ndërtimi, 3 karpentierë, 2 manovratorë etj.

4. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë "BOSHNJAKU.B" shpk & "PESE VELLEZERIT" shpk**, me adresë Lagjja "Bishanake", Rruga "Skënderbeu", Nr. 8, Pranë karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr.8532, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **60.416.378** (gjashtëdhjetëmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.08.2018

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Agron Kapllanaj

